

BASHKIA GJIROKASTER

Adresa: Sheshi "ÇerçizTopulli", Gjirokaster, Shqiperi. Tel: ++355 84 26 4103/26 2424/ 26 3500. Fax: ++355 84 26 3796



**Objekti: "Masa parandaluese të rrëshqitjes së shpatit të malit,
në fshatin 'Kolonjë'".**

BASHKIA GJIROKASTËR

SPECIKIME TEKNIKE

Hartoi: Ing. Aleksandri Pesha Nr.lic.K.0797/2

Ing. Spiro Diamanti`

QERSHOR 2026

BASHKIA GJIROKASTER

Adresa: Sheshi "Çerçiz Topulli", Gjirokastrë, Shqipëri. Tel: ++355 84 26 4103/26 2424/ 26 3500. Fax: ++355 84 26 3796

1 TË PËRGJITHSHME

1.1 Hyrje

Paragrafët në këtë kapitull janë plotësuese të detajeve të dhëna në Kushtet e Kontratës. Qëllimi i këtyre specifikimeve është të përcaktohet mënyra e zbatimit, kërkesat teknike, standardet e materialeve, kontrolli i cilësisë, si dhe mënyra e matjes dhe pagesës për punimet e parashikuara në projekt.

1.2 Zëvendësimet

Zëvendësimi i materialeve të specifikuara në Dokumentet e Kontratës do të bëhet vetëm me aprovimin me shkrim të Mbikëqyrësit të Punimeve, në rast se:

- a) materiali i propozuar është i njëjtë ose më i mirë se ai i specifikuar; ose
- b) materiali i specifikuar nuk mund të sigurohet në kohë për arsye jashtë kontrollit të Sipërmarrësit.

Kërkesa për zëvendësim duhet të shoqërohet me dokumentacion cilësie, certifikata, si dhe afatet e garantuara të furnizimit nga furnizuesit për të dy materialet.

1.3 Dokumentat dhe vizatimet

Sipërmarrësi do të verifikojë të gjitha dimensionet, sasinë dhe detajet e treguara në vizatime e dokumente. Punëdhënësi nuk mban përgjegjësi për mospërputhje të evidentuara në terren. Moszbulimi i gabimeve nga Sipërmarrësi nuk e lehtëson atë nga përgjegjësia për punë të pakënaqshme. Në rast mospërputhjeje, udhëzimet zyrtare do të jepen nga Mbikëqyrësi dhe/ose Punëdhënësi.

1.4 Kostot e mobilizimit dhe punimet e përkohshme

Nuk do të kryhen pagesa të veçanta për mobilizimin. Në çmimet njësi konsiderohen të përfshira: transporti, energjia, ndriçimi, pajisjet, veglat, magazinimi, rrugët e hyrjes provizore, shërbimet sanitare, menaxhimi i mbetjeve, furnizimi me ujë, masat kundër zjarrit, rojet, sinjalizimi, si dhe çdo strukturë/pajisje e përkohshme e nevojshme për zbatimin e punimeve.

1.5 Hyrja në sheshin e ndërtimit

Sipërmarrësi organizon ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të hyrjes. Në përfundim, zona do të rikthehet në gjendje të pranueshme, me siguri dhe drenazh të paktën të njëjtë me gjendjen para ndërhyrjes.

1.6 Furnizimi me ujë

Uji për punimet do të merret nga rrjeti kryesor ku është e mundur. Sipërmarrësi siguron rrjetin provizor dhe matësin. Në mungesë të rrjetit, furnizimi me ujë higjienik të pastër është detyrim i Sipërmarrësit.

1.7 Furnizimi me energji elektrike

Sipërmarrësi siguron energjinë elektrike në kantier me lidhje në rrjetin lokal ose me gjenerator, sipas kushteve të terrenit.

BASHKIA GJIROKASTER

Adresa: Sheshi "Çerçiz Topulli", Gjirokaster, Shqiperi. Tel: ++355 84 26 4103/26 2424/ 26 3500. Fax: ++355 84 26 3796

1.8 Pikëtimi i punimeve

Sipërmarrësi kryen pikëtimin me shpenzimet e tij dhe mban përgjegjësi për përpikmërinë. Nuk lejohet devijim nga akset/kuotat e projektit pa miratim me shkrim. Çdo punë jashtë kufijve të projektit nuk paguhet dhe korrigjohet nga Sipërmarrësi.

1.9 Fotografitë e kantierit

Sipërmarrësi kryen fotografimin para, gjatë dhe pas punimeve, sipas udhëzimeve të Mbikëqyrësit. Shpenzimet përfshihen në kostot administrative të Sipërmarrësit.

1.10 Bashkëpunimi në zonë

Punimet kryhen në zona të kufizuara. Sipërmarrësi garanton kalimin e banorëve dhe koordinimin me kontraktorë të tjerë të mundshëm në zonë.

1.11 Mbrojtja e punës dhe e publikut

Sipërmarrësi merr të gjitha masat për sigurinë e punëtorëve dhe të publikut, vendos pengesa, drita paralajmëruese, sinjalistikë dhe vrojtues, sidomos aty ku punimet ndikojnë trafikun ose paraqesin rrezik.

1.12 Mbrojtja e ambientit

Sipërmarrësi duhet të shmangë ndotjen e ujit, tokës dhe ajrit (përfshirë zhurmat). Mosrespektimi i kësaj klauzole mund të çojë në ndërprerjen e kontratës.

1.13 Transporti dhe magazinimi i materialeve

Transporti bëhet me mjete të përshtatshme pa derdhje. Materialet stivohen dhe magazinohen të mbrojtura, të disponueshme për kontroll nga Mbikëqyrësi.

1.14 Vizatimet "Sic është zbatuar"

Sipërmarrësi mban evidenca dhe përgatit vizatimet "as-built". Kostot konsiderohen të përfshira në shpenzimet administrative.

1.15 Pastrimi përfundimtar

Në përfundim, Sipërmarrësi pastron kantierin, heq materialet e tepërta dhe strukturat e përkohshme. Pagesa përfundimtare lidhet me dorëzimin e sheshit të pastër dhe të pranueshëm.

1.1 Provat dhe kontrolli i cilësisë

Provat (kur kërkohen) kryhen sipas standardeve shqiptare ose ndërkombëtare të aprovuara. Marrja e kampioneve, transporti dhe analizat kryhen nga Sipërmarrësi në laborator të miratuar.

BASHKIA GJIROKASTER

Adresa: Sheshi "Çerçiz Topulli", Gjirokaster, Shqiperi. Tel: ++355 84 26 4103/26 2424/ 26 3500. Fax: ++355 84 26 3796

2. GËRMIMET

2.1 Qëllimi

Ky seksion përcakton kërkesat për gjermime në tokë (me krah ose makineri), gjermime për themele, gjermime për struktura, trajtimin e materialeve të papërshtatshme, si dhe rifiniturat e shpatit të prerjes.

2.2 Përcaktime

- Dhera: materiale që gjermohen me krah ose me makineri.
- Materiale të përshtatshme: materiale që mund të përdoren për mbushje, të ngjeshshme sipas kërkesave.

2.3 Zbatimi i gjermimit

- a) Gjermimi kryhet sipas niveleve dhe vijave të projektit.
- b) Ndalohet gjermimi përtej vijës së prerjes që cenon stabilitetin e shpatit.
- c) Përmasat përputhen me seksionet tip të projektit.

2.4 Trajtimi/Ngjeshja e zonave të gjermuara

- Zonat horizontale të gjermuara ngjeshen min. 95% densitet i thatë për dhera të shkrifët dhe 90% për dhera të lidhur (kur kërkohet).

2.5 Pastrimi i sheshit

Pastrohen shkurret, ferrat, rrënjët, mbeturinat. Materialet largohen në vende të miratuara.

2.6 Largimi i ujërave

Sipërmarrësi siguron drenazhime, kanale kulluese, pompim, etj., pa kosto shtesë, për të mbajtur gjermimet të thata dhe të sigurta.

2.7 Matjet

Zërat e gjermimeve maten në m³, sipas dimensioneve të projektit dhe matjeve faktike të aprovuara nga Mbikëqyrësi.

3 NDËRTIMI I MUREVE MBAJTËSE ME GABIONA

Ndërtimi i gabioneve do të realizohet në segmente të kufizuara, në mënyrë që të mos stimulohen shkarje/rrëshqitje të shpatit gjatë gjermimeve dhe montimit. Gjatësia e segmentit të punës do të përcaktohet nga Sipërmarrësi gjatë zbatimit dhe do të miratohet nga Mbikëqyrësi, në varësi të kushteve reale të terrenit.

BASHKIA GJIROKASTER

Adresa: Sheshi "Çerçiz Topulli", Gjirokastrë, Shqipëri. Tel: ++355 84 26 4103/26 2424/ 26 3500. Fax: ++355 84 26 3796

3.1 Materialet dhe standardet

Rrjeta e gabioneve do të jetë rrjetë metalike me përdredhje të dyfishtë, hapje heksagonale 80×100 mm, sipas **UNI EN 10223-3**. Veshja antikorrozive do të realizohet me përzierje Zn-Al (Zn.Al 5%), sipas **UNI EN 10244-2**, me rezistencë të lartë ndaj korrozionit. Prodhimi do të jetë sipas standardit të menaxhimit të cilësisë **ISO 9001**.

Ose ekuivalente dhe e vlefshme

Telat dhe aksesorët (minimumet):

- Teli i rrjetës: Ø 3.0 mm, i galvanizuar
- Teli i bordurës/skajeve: Ø 4.0 mm, i galvanizuar
- Teli i qepjes/lidhjes: Ø 2.2 mm, i galvanizuar
- Shufra lidhëse: Ø 4.5 mm (për formim qoshe dhe lidhje të fortë ndërmjet koshave)

Kërkesa mekanike:

- Zgjatimi i telit jo më pak se 10%.
- Testet mbi kampione min. 25 cm.

3.2 Dimensionet e gabioneve

Gabionet do të jenë të dimensioneve sipas projektit dhe preventivit, p.sh.:

- 1×1×1.5 m,
 - 1×1×1.0 m, (dhe në raste të tjera sipas projektit: 0.5×1×1 m; 1×2×1 m, etj.).
- Gabionet janë të parashikuara të montueshme në vend, me diafragma sipas dimensioneve të koshave.

3.3 Gjurmimi dhe shtrati i vendosjes

- Gjurmimi për themelet kryhet me makineri ose me krah.
- Duhet ruajtur struktura natyrore e tokës në tabanin e themelit.
- Nëse baza është e papërshtatshme, gjurmimi vazhdon deri në taban të qëndrueshëm me miratim të Mbikëqyrësit.
- Në fund parashikohet shtresë nivelimi rërë t = 10 cm (ose sipas projektit).

Materiali i dalë nga gjurmimi nuk lejohet të përdoret për mbushje pas murit gabion.

3.4 Montimi dhe lidhja

- Gabionet montohen dhe lidhen fort me njëra-tjetrën me tel qepjeje dhe shufra Ø4.5 mm.
- Lidhjet duhet të garantojnë formim të saktë të qosheve, të shmangin hapjen e strukturës dhe të sigurojnë bashkëpunim të plotë të koshave fqinjë.
- Sipërmarrësi merr masa për të mos deformuar panelët gjatë mbushjes.

BASHKIA GJIROKASTER

Adresa: Sheshi “Çerçiz Topulli”, Gjirokaster, Shqiperi. Tel: ++355 84 26 4103/26 2424/ 26 3500. Fax: ++355 84 26 3796

3.5 Mbushja me gur kave

- Mbushja bëhet me gurë kave të fortë dhe të pastër, pa dhera/argjilë.
- Gurët e fasadës vendosen me dorë, “si mur guri i thatë”, për stabilitet dhe paraqitje të rregullt.
- Mbushja kryhet me shtresa, duke kontrolluar vazhdimisht deformimin e rrjetës.

3.6 Përforcimi në krye (kur parashikohet në projekt)

Kur projekti parashikon përforcim në krye të murit:

- vendoset hekur Ø18 mm (i lidhur/inkastruar me rrjetën) dhe
- realizohet shtresë betoni C16/20, trashësi $t = 10$ cm, për forcim të kurorës së murit.

3.7 Mbushja pas murit

Mbushja pas mureve mbajtëse kryhet me material shkëmbor, pa përqindje të lartë dherash, në shtresa 20 cm, të niveluara dhe të ngjeshura.

3.8 Matja dhe pagesa

- Gabionet maten në m^3 sipas volumit të vendosur dhe të pranuar.
- Përfshihen: montimi, lidhjet, telat, aksesorët, mbushja me gur, mbyllja e kapakëve, dhe çdo punë ndihmëse për përfundimin korrekt.

4. RRETHIM ME KOLONA B/A + RRJETË TELI (H = 1.5 M)

4.1 Materialet

- Kolona b/a (të parapërgatitura), me seksion tipik 8–10 cm (sipas projektit)
- Armaturë: hekur Ø6–Ø10 mm (sipas detajit konstruktiv)
- Tel zinku / aksesorë fiksimi
- Rrjetë teli e galvanizuar për rrethim

4.2 Gërmimi i gropave dhe vendosja

- Gropat hapen sipas përmasave të përcaktuara.
- Kolonat vendosen vertikalisht, kontrollohen me nivel dhe betonohen.
- Pas ngurtësimit, vendoset rrjeta, tensionohet dhe fiksohet me kapëse/tela.

4.3 Matja dhe pagesa

- Rrethimi matet në m^2 sipas sipërfaqes së vendosur dhe të pranuar.
- Çmimi përfshin: kolonat, betonimin, rrjetën, telat, aksesorët, dhe çdo punë ndihmëse.